



PROCESVERBAL 8/2024

I Mbajtur në takimin e VIII- të të rregulltë të KPF-së me datën **28.08.2024**, në ora **10⁰⁰** në Zyrën e takimeve të Kryetari i Komunës, nën kryesimin e Kryesuesit të KPF-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. Xhavit Zariqi, Kryesues;
2. Arian Imeri, Anëtar
3. Lumnije Morina, Anëtare;
4. Mimoza Pajaziti, Anëtare;
5. Lulzim Abazi, Anëtar;
6. Brahim Osmani, Anëtar;
7. Shqipe Jashari, Anëtare;
8. Hatixhe Bungu Qerimi, Anëtare;
9. Flamur Istrefi, Anëtar dhe

Drejtorët e drejtorive;

1. Arbër Bytyqi - Drejtor i Urbanizmit dhe Mjedisit;
2. Sabri Murseli - Drejtor i Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë;
3. Afrim Llabjani – Drejtor i Arsimit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Përshëndetje të pranishëm, anëtarë të kuvendit, shoqëria civile, Drejtor të drejtorive, pra po fillojmë me mbledhjen e VIII-të të rregullt të KPF-së, besoi që materialin e keni marr me kohë dhe ju dëshiroi mirëseardhje në mbledhjen e KPF-së dhe propozojë këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluara të KPF-së;
4. Propozim - Vendim për daljen në Diskutim Publik të Draft Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026;
5. Propozim - Vendim për shfuqizim të Vendimit 01.Nr. 79 të datës 25.05.2018;
6. Propozim - Vendim për Miratimin e Raportit të Vlerësimit të Dëmeve;
7. Raportet e Ndërmarrjeve Publike;

- K.R.M. "PASTËRTIA" SH.A. FERIZAJ.
- SH.A "AMBIENTI" NË FERIZAJ
- SH.A. "STACIONI I AUTOBUSËVE" NË FERIZAJ

8. Propozim - Vendim për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronës;
9. Propozim - Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale me nr.489-9 Z.K. Ferizaj dhe objektit përcjellës N.P.L Stacioni i Autobusëve SH.A;
10. Propozim - Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të ngastrës kadastrale 2094-0 dhe 2447-0 Z.K.Ferizaj;
11. Propozim - Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 721-0 Z.K Nekodim me sipërfaqe 1426 m² pronë private;
12. Propozim - Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 631-2 Z.K. Talinovc i Jerlive, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 690-5 Z.K. Talinovc i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt;
13. Propozim - Vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale; 784-0, 785-0 Z.K.Manastirc, prona private, me pjesët e ngastrave kadastrale 138-0, 130-0 Z.K.Manastirc, prona të Komunës së Ferizajt;
14. Propozim - Vendim për këmbimin e pjesës të ngastrës kadastrale; 3621-14 Z.K. Jezerc, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 3485-4, Z.K. Jezerc, pronë e Komunës së Ferizajt;
15. Propozim - Vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale; 3286-0 Z.K. Ferizaj, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 489-16 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt;
16. Propozim - Vendim për këmbimin e pjesës të ngastrës kadastrale; 963-1 Z.K. Talinovc i Muhaxherëve, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 7-0, Z.K. Muhovc, pronë e Komunës së Ferizajt;
17. Propozim - Vendim për këmbimin e pjesës të ngastrës kadastrale; 532-5 Z.K. Talinovc i Jerlive, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 690-5, Z.K. Talinovc i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt;

18. Propozim - Vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale; 667-1 dhe 667-2 Z.K. Talinocv i Muhaxherëve, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 286-0 Z.K. Talinocv i Muhaxherëve, pronë e Komunës së Ferizajt dhe
19. Të ndryshme.

Pikat shtesë:

1. Propozim – ndryshim i Vendimit 01.Nr. 56 i datës 20.06.2024 për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033;
2. Propozim - Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të objekteve të institucioneve Parashkollore-Çerdheve.

Pika 1

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së, të gjithë jemi prezent.

Pika 2

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – A ka dikush të diskutoi për rend dite, fjalën i'a dha Drejtorit Afrim Llabjanit.

Afrim Llabjani - Faliminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë, unë e propozoi që të rikthehet pika Propozim - Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të objekteve të institucioneve Parashkollore-Çerdheve dhe të diskutohet edhe një herë në seancën e kuvendit të radhës.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – A ka një material apo ndonjë propozim të ri, apo qysh e kena pas.

Afrim Llabjani - Mujna me dhanë arsyetime edhe në kuvend, na kena ba edhe kalkulime edhe në aspektin buxhetor se qysh na kanë kushtu deri tash, sidomos qerdhet me KARITAS dhe që kemi mendu të plotësohet kjo buxheti i komunës, nëse bahet ashtu si kemi mendu, duke u bazuar në Ligjin për Edukimin Parashkollor të Ministrisë.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Normal që buxheti shtohet se na nuk mundemi me i pagu, nuk jam kundër, nëse kjo pikë në seancën e kalume është shty për arsye të sqarimeve të paqarta se çka është dashur me u ba, krejt e kena shty këtë propozim, se nuk është në rregull qysh ashtë, por nëse nuk kemi arritur të shtim propozim të ri, nuk di pse me shti në rend dite.

Afrim Llabjani – Kryesues ka sqarime, unë kam dhanë sqarime edhe atë ditë, por në fakt opozita e lëshoi sallën edhe një pjesë e qytetarëve e lëshoi sallën, kam dhanë sqarime, qato sqarime shtesë që i kam dhanë, vlejné qato thash për buxhetin dhe normal që buxheti në momentin që ne këto I privatizojmë dhe i qesim këto në ankand publik edhe ipen me koncension, po ajo që kemi mendu me shumë është përfshirja e më shumë fëmijëve nëpër Çerdhe, ne i kemi sipas statistikave që janë ma pak se 30% të fëmijëve në pushime, në çerdhe të institucioneve, në edukimin arsimor të

hershëm, i kemi vetëm dy çerdhe, njëra publike dhe tjetra që është me KARITAS, këtu që kemi është p.sh. hyrja ditore nga investimi i fëmijëve është 100,000.00€ për secilën çerdhe, vlera e kontratës së fundit e lidhur nëpërmes të komunës dhe të KARITAS-it 550,000.00€, pagesat për ushqim vetëm për një çererdhe janë 25,000.00€ vjetore, d.m.th. për 250000 fëmijë të sistemuar.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Unë nuk jam për mos me shti në rend dite, nëse t'i nuk na ki pru naj propozim të ri tjetër, unë kam dashtë sqarim të plus, e kur ta shtim në rend ditë kemi me kërku sqarime.

Afrim Llabjani – Këto sqarime që i kena dhanë, kena mi dhanë edhe e kemi shtesën e materialit, për atë arsye e kena pru këtë propozim.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Unë jam me shti në rend dite po nuk besoi që ka me kaluar në kuvend, kështu me këtë materialkonkret.

Afrim Llabjani – I kemi na arsyetimin shtesë dhe kështu e kemi pru si propozim.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Në rregullë.

Flamur Istrefi – Faliminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, Drejtori përmendi që në seancë ka dështu pika e rendit të ditës për shkak të opozitës, tani tha edhe për shkak të azhurancës, tani tha që edhe për shkak të hujve që kanë dalë, e ne i kemi mbështet, ka qenë ideja e jote nuk duhet të mendoni një gjë të tillë, por ju e keni një menagjim jo të mirë dhe se mendoni se është politike.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Nuk është politike.

Flamur Istrefi – Jo kryesues, drejtori ka ardh me propozim të njëjtë dhe qato sqarime krejt i ki, se buxheti është ma i ultë ma i mirë kret varet nëse në herën e parë e ki pru draft edhe herën e dytë e lyp një të dokumentin, normalisht që e lëshojmë sallën, jo sqarime kryesues por propozim në kuvend, por rezultati po mendoj se ka me qenë prap i njejt.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Pikërisht unë e kërkoja materialin për me pa se çka ka ndryshu me ate, shka ka propozu, e nëse e keni materialin gati, seanca është mbas nesër, po mirë e qesim në kuvend, Drejtor nëse e përgatit materialin po e qesim për kuvend, kush është për?, faliminderit, 5 për, 2 kundër, 0 abstenim pra kalon, kjo pikë shtesë pra ishte;

Afrim Llabjani - Propozim - Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të objekteve të institucioneve Parashkollë-Çerdheve.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Dikush tjetër për këtë rend dite.

Arbër Bytyqi – Po kryesues, nëse banë, Propozim – ndryshim i Vendimit 01.Nr. 56 i datës 20.06.2024 për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033, ishalla kësaj radhe nuk e kthejnë, plotësim ndryshimi ka ardhur me vonës, pasi na kanë ardhur pikat ta kemi si propozim në kuvend, na kanë kërkuar edhe një raport shtesë.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi - Propozim – Ndryshim i Vendimit 01.Nr. 56 i datës 20.06.2024 për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033, dikush tjetër?, a jeni që të futet në rend dite dhe të kaloj në kuvend, Propozim – Ndryshim i Vendimit 01.Nr. 56 i datës 20.06.2024 për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033, kush është për, faliminderit, 7 për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon kjo pikë shtesë, dikush tjetër për rend dite?, atëhere po vazhdojmë me pikën e III-të të rendit të ditës.

Pika 3

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Po vazhdojmë me miratimin e procesverbalit të mbledhjes të kaluar, a ka dikush të diskutoi për ndonjë vërejtje apo sygjerime për procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KPF-së?,

Flamur Istrefi – Faliminderit Kryesues, unë kam një kërkesë që të përmirësohet procesverbali pasi që fjalën time kryesore mungon dhe fjalimin rreth diskutimit që e kam pas me Lulzim Abazin nuk dihet se kush shka ka folë, kërkoi që të përmirësohet!

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faliminderit, dikush tjetër, nuk ka, pra me këtë propozim të Flamurit për ndryshim e procesverbalit e procesojmë në kuvend, kush është për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar?, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e IV-të,

Pika 4

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për daljen në Diskutim Publik të Draft Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjimore 2024-2026, kush e ka propozu këtë?

Shyhrete Rexhepi – Këtë propozim e ka ba Besa dhe Nënkryetari, mbasi nënkryetari është në pushim mundeni me kalu për në kuvend me diskutu.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit, kush është për procesimin e kësaj pike në kuvend?, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e V-të,

Pika 5

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për shfuqizim të Vendimit 01.Nr.79 të datës 25.05.2018, kush është që të na sqaron për këtë pikë?, çka është tu dashtë me u shfuqizu ky vendim?

Arbër Bytyqi – Është dashtë të shfuqizohet vendimi 01.Nr. 79 i datës 25.05.2018, e keni prapa arsyetimin me çka ka të bëjë ky vendim, ky propozim vendim bahet për shfuqizim për arsye se komuna ka kruju në vazhdimësi obligime që nuk ka pas nevojë dhe për shkak të ndryshimit të ligjit për marrëdhënie detyrimore që tash e tutje nuk lejohet bartja e borxheve në vitin e ardhshëm dhe kërkojmë që ky vendim të shfuqizohet, duhet të bëjë me këste për leje ndërtimore.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush diçka për të diskutu?, urdhëro.

Brahim Osmani – Mbasi e përmendi drejtori për shfuqizim të vendimit, kështu e lejeve ndërtimore a duhet me i pagu menjëherë?

Arbër Bytyqi – Komplet duhet me i paguar me leje ndërtimore, obligimi që bëhet ndaj komunës, për shkak që tash ligji ka ndryshu dhe ma nuk lejohet me u bartë borxhi në vitin tjetër, tash duhet me u ba që në momentin që e merr lejen duhet me i paguar pagesat, qashtu duhet me kanë ky vendim, e kjo i ka krijuar favore bizneseve po komuna ka pas vështirësi për zbatim të këtij vendimi.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit drejtor, dikush tjetër, kush është për procesimin e kësaj pike në kuvend?, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e VI-të,

Pika 6

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për Miratimin e Raportit të Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve, a ka dikush që na sqaron për këtë pikë?, kush është për procesimin e kësaj pike në kuvend?, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e VII-të,

Pika 7

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Raportet e Ndërmarrjeve Publike;

- K.R.M. “PASTËRTIA” SH.A. FERIZAJ.
- SH.A “AMBIENTI” NË FERIZAJ
- SH.A. “STACIONI I AUTOBUSËVE” NË FERIZAJ

Besoi që nuk ka nevojë të diskutohet këtu e procesojmë në kuvend, a jeni që të kaloi në kuvend?, faleminderit; 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e VIII-të,

Pika 8

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronës.

Sabri Murseli – Faleminderit kryesues, ky Propozim - Vendim ka të bëjë për “Stacionin e autobusëve” për marrjen e të drejtës të shfrytëzimit të pronës, mbasi “Stacioni i autobusëve” është bërë i ri dhe do të bartet në ambient të ri dhe ky vend do të lirohet dhe do të ipet ambientit për 5 vite stacioni aktual, pra stacioni i autobusëve e ka aktin e themelimit kur është ndërtu dhe kur u themelu, ja ka dhanë të drejtën për shfrytëzim Stacionit të autobusëve, e kemi gjetur shkresat e stacionit, një konfirmim 2005, kështu që thotë e ka një posedim që nga themelimi e që vjenë si pasuri shoqërore e Komunës së Ferizajt aty në ngastrën kadastrale, e kështu që na e marrim të

drejtën në këtë pronë dhe e bartim në emër të stacionit tjetër, kjo lirohet e mandej ipet në shfrytëzim “Ambientit” me një vendim që është e drejtë e shfrytëzimit.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit drejtor, dikush tjetër, kush është për procesimin e pikës së VIII në kuvend?, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e IX-të,

Pika 9

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale me Nr.489-9 Z.K. Ferizaj dhe objektit përcjellës N.P.L Stacioni i Autobusëve SH.A. a ka dikush të na sqaroi për këtë pikë?, udhëro Drejtor

Sabri Murseli – Ky propozim Vendim ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim afat gjatë për 50 vite, Stacioni aktual që është ndërtu që zona kadastrale është me Nr.489-9 Z.K. Ferizaj dhe objektit përcjellës N.P.L Stacioni i Autobusëve SH.A. i ipet pa kompensim për stacion dhe zyre si aset.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Pse me ja dhanë stacionit, veç mos na pshtjell, p.sh. “Stacioni i autobusëve” me dhanë në shfrytëzim, kujna me ja dhanë në shfrytëzim.

Sabri Murseli – Stacionit, ka ardhë si subjekt në emër të stacionit, se realisht komuna e ka maru.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – “Stacioni i autobusëve”, lokaleve.

Sabri Murseli – Këtu shkruan, “Stacionit të autobusëve” N.P.L. e që aksionari 100% është komuna.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush të diskutoj, kush është për procesimin e pikës së IX në kuvend?, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e X-të,

Pika 10

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të ngastrës kadastrale 2094-0 dhe 2447-0 Z.K.Ferizaj, a ka dikush të diskutoi, urdhëro!

Sabri Murseli – Kryesues kjo pikë ka të bëjë me “Stacionin e autobusëve” për zyre dhe parking dhe në momentin që Stacioni i autobusëve kalon në ndërtesën e re, N.P.L. “Ambienti” kalon në zyret e “Stacionit të autobusëve”.

Brahim Osmani – Unë kisha dashtë me ditë pak se kryetari aty ka pas me ba park, e që ka pas me destinu për zyre të ambientit, unë mendoj që përpos që jam kundër, ju po dilni kundër vendimeve, premtimeve, e që vet i keni ba për park, e tash dyshimin e kam që park nuk ka mu ba asnjëherë, por tash po ja jepni njëfarë rruge tjetërkujna që me hi menjëherë pas përfundimit të “Ambientit” me hi tjetërkush aty, unë jam kundër këtij vendimi edhe për shkak edhe vendimeve të juve edhe vendimeve që me i pru, për shkak kundërshtimeve me vetvete që keni premtu.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faliminderit Ibrahim, dikush tjetër?

Flamur Istrefi – Kryesues unë në parim po e mbështes, se është kompani e komunës, por e kam këtu që tha edhe Braha edhe në buxhet edhe në ndërtim ka qenë që dy herë me pas buxhet pak dhe pasi që barten në stacion të ri stacioni i vjetër me u ba park tha drejtori edhe pse kanë hjek dorë edhe sa e di pse kanë hjek dorë, edhe pse “Ambienti” andej edhe “Plus marketi” me ju dhanë parcelë për ndërtimin e një objektit, tash nuk e di pse ky ndryshim, unë e mbështes për me ju kthy hapësira, e kemi krejt gjelbërim, parqe të reja pse me ndodhë.

Sabri Murseli – Ideja është kryesisht se unë mendova se kërkuat prej meje sqarimet, për çështjen e parkut.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Nuk ka kërkuar sqarim ky por e ka dhanë mendimin e vet, por nuk ki se për çka me dhanë sqarim, dikush tjetër për diskutim.

Sabri Murseli – Vendimi Brahë është dhënë në shfrytëzim të përkohëshëm, është 5 vite, pikën 3 të vendimit është për dhënien në shfrytëzim ngastrën kadastrale për objekt, me vendim është 5 vite, vendimi mund të shfrytëzohet edhe para kalimit të periudhës prej 5 viteve nëse Komunës së Ferizajt i duhet prona apo “Ambienti” SH.A. ndërton objektin për zyre, na e këna lanë alternativë, tash pjesa këtu është për zyre dhe parkë dhe për nevoja të punëtorëve të “Ambientit”, nëse nuk kena buxhet sivjet me funksionalizu si park, atëherë e shfrytëzojmë përkohësisht, e mandej funksionalizohet pjesa e parkut, në pikën 2 të këtij vendimi përshkruhet mirë, e në kontratë duhet të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet, e të nënshkruhet nga ana e dy palëve, shumë mirë shkruan në kontratë nga zyra ligjore që përpilohet, kështu që parcelën e kena nda për objektin e “Ambientit”, nëse në vitin e ardhëshëm kryhet objekti për “Ambintin”, tash kjo është zgjidhja e përkohëshme për “Ambientin”, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faliminderit, dikush tjetër?

Arbër Bytyqi - Mu lidhë me qata shka tha drejtori, qëllimi kryesor është që prania e “Ambientit” aty që funksionalizon është që me zyre nuk është në gjendje jo të mirë edhe duhet me ju ba një zgjidhje ma të mirë të përkohëshme, me kalu ata përkohësisht aty, derisa të përfundon objekti i Ndërmarrjes “Ambienti”, moment që përfundon, ata kalojnë në objekt dhe lirohet prap, këtu destinimi nuk është tu ju ndru por është tu ju dhanë në shfrytëzim të përkohëshëm, që Ndërmarrjes “Ambientit” me ju kriju kushte ma të mira të punës.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush të diskutoj, kush është për procesimin e pikës së X në kuvend, faleminderit?, 5 vota për, 1 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e XI-të,

Pika 11

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 721-0 Z.K. Nekodim me sipërfaqe 1426 m² pronë private, Drejtor a po na kalxon çka është kjo.

Sabri Murseli – Po kryesues kjo ka qenë në muajin e kaluar, por tashë ka ardhur kjo kërkesë, është për SH.P.K. “Daakonnin” që ka kërku thjesht kompensimin me koeficient, unë e kam sqaru në ministri këtë çështje, në aspektin ligjor komuna nuk ka telashe, nëse komuna e përfiton këtë benefit, mund ta bëjë kompensimin me koeficient, por ka formë tjetër për me e kompenzu, me mjete monetare ose me këmbim ose me koeficient, pjesa e palës ka kërku me koeficient ndërtimi, kështu që na ndikojna me konstatu, është ai ligji për bonuse por komuna nuk ka rregullore të veçantë, e si kontekst Komuna mundet përmes të vendimit të kuvendit me ja kompenzu në këtë formë, unë në ministri e kam sqaru këtë çështje, sido që të jetë nëse kalon tutje kjo çështje është mirë, e nëse nuk kalon tutje, kërkon përsëritje.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush të interesuar për diskutim?

Brahim Osmani – Faleminderit Kryesues, unë vetëm sa për sqarim, në mbledhjen e kaluar të KPF-së qëndrime e kemi dhanë për vite e vite, e kështu që edhe që del në seancë, qëllimi është i njëjtë edhe në seancë.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Urdhëro Flamur.

Flamur Istrefi - Faleminderit kryesues, njetë edhe unë mendojë që qëllimi është i njëjtë, por unë mendoi kundër, që duke marr parasysh se dokumenti ka ardhë prej seancës së kaluar pa asnjë ndryshim, si propozim e diçka tjetër, kam thanë edhe në herën e kaluar që nuk duhet me hi dokumenti në Kuvend të komunës, mendoi se duhet t’i bëhet një zgjidhje, sepse nëse ka të drejtë ai, duhet me ja dhanë të drejtën, me ja dhanë kompenzimin, mi dhanë mjete monetare ose mi ba këmbim, edhe drejtori me ja dhanë lejën për tri kate tjera, por këtu është situata që edhe në herën e kalume dyshohet që duhet me hy pak ma thell, janë objekte të shumta që janë në kundërshtim me ligjin e duhur që brenda 25 m me hekurudhë, kështu që unë dua me hjekë përgjegjësin prej vetës dhe se nuk dua të merrem me këtë punë dhe nuk jam i pajtimit dhe që i rri gati kësaj pune.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Flamur, dikush tjetër, kush është që të kaloi në kuvend pika e XI-të, faleminderit?, 4 vota për, 3 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e XII-të.

Pika 12

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 631-2 Z.K. Talinoc i Jerlive, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 690-5 Z.K. Talinoc i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt, urdhëro drejtor.

Sabri Murseli – Ky propozim vendim ka të bëjë me shpalljen interes i përgjithshëm me qëllim të këmbimit, e nuk e di qysh ka mbetur prej 2016 -2017, janë nxerr dy vendime për shpronësim në rrugën “Driton Islami” dhe në këtë parcelë nuk është përfshirë shpronësimi, e kam marr si obligim moral me ja ba një zgjidhje, se Komuna nuk ka të planifikuar buxhet për shpronësim për këtë projekt sepse është përfunduar, kjo është në rrugën “Driton Islami” është marr si projekt në zonën kadastrale, propozimi im është që të këmbëhet pjesa e ngastrës kadastrale 690-5Z.K. Talinoc i

Jerlive, këmbimi do të bëhet mbas vlerësimit nga ministria, kështu që ky është vendim vetëm për vlerësimin e pronës, faleminderit.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Sa sipërfaqe?

Sabri Murseli - 58 m².

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush tjetër, kush është që të kaloj në kuvend pika e XII-të, faliminderit?, 5 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e XIII-të.

Pika 13

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale; 784-0, 785-0 Z.K.Manastirc, prona private, me pjesët e ngastrave kadastrale 138-0, 130-0 Z.K.Manastirc, prona të Komunës së Ferizajt;

Sabri Murseli – Kryesues ky propozim ka të bëjë me këmbim, për këto parcela bëhet vlerësimi nga ministria, këna shumë dallim në vlera, po unë kisha me dhanë se pala ka dhanë deklaratë për këmbim kështu që këmbëhet pjesa e parcelës 784-0 Z.K. Manastirc me sipërfaqe 384 m², parcela 783-0 Z.K. Manastirc me sipërfaqe prej 1830 m², kurse ngastra kadastrale 138-0 Z.K. Manastirc me sipërfaqe 151 m² pronë e Komunës së Ferizajt dhe pjesa e ngastrës kadastrale 130-0 Z.K.Manastirc me sipërfaqe prej 386 m², prona të Komunës së Ferizajt, kështu që i marrim 26 ari për 5 ari.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush tjetër, kush është që të kaloj në kuvend pika e XIII-të, faliminderit?, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e XIV-të.

Pika 14

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për këmbimin e pjesës të ngastrës kadastrale; 3621-14 Z.K. Jezerc, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 3485-4, Z.K. Jezerc, pronë e Komunës së Ferizajt;

Sabri Murseli – Kryesues këtu është ba dami, se komuna nuk e ka shtru asfalt këtë pjesë dhe e ka qitë pala kërkesën tjetër, tash prap ka qenë kërkesa e palës për parcelën 3621-14, është një sipërfaqe me vlera, por kërkon garancë për këtë pikën shtesë, për këmbim janë 518m², e që pala private i jep 518m² dhe i merr 334 m².

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Drejtor banu i sinqertë, deklaroi që nuk kërkon kompensim shtesë, duhet me ba deklaratë me shkrim me nënshkrim se krejt po e bajnë kështu e mandej po kërojnë prap, këtë punë unë e di, me dhjetëra raste ka kështu, njëherë thuni nuk ka problem na nuk kemi ma shumë, e masanej kërkoni vlera ma shumë, e thuni hajde kërkoni se ta këna marr na dhe kjo është e saktë.

Sabri Murseli – Mirë po thuani kryesues, për budallaki nuk na shkon ky proces, është edhe seanca e dytë.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Dhe thuani çka u ba se këto sene që ndodhin në Ferizaj, e në Jezerc nuk besoi që nuk kemi kurrfarë interesi.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush tjetër, kush është që të kaloj në kuvend pika e XIV-të, faliminderit?, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e XV-të.

Pika 15

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale; 3286-0 Z.K. Ferizaj, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 489-16 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt;

Sabri Murseli – Kryesues ky propozim ka të bëjë me këmbim, është bërë vlerësimi për këto zona nga Ministria, është fjala për këto pjesë të ngastrave kadastrale; 3286-0 Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe 341 m² pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 489-16 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt me sipërfaqe 341 m², te kyqja te stacioni i ri te rruga “Driton Islami” te qajo pjesa që është rrethi në projekt,

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Edhe këtu sa për dioni e keni ba këtë projekt, po është e vërtet, na Stacionin nuk mundemi me me pengu, po marrveshja mund të kryhet, po tani duhet me pas kujdesë.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush tjetër, kush është që të kaloj në kuvend pika e XV-të, faliminderit?, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e XVI-të

Pika 16

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për këmbimin e pjesës të ngastrës kadastrale; 963-1 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 7-0, Z.K. Muhoc, pronë e Komunës së Ferizajt, udhëro drejtor, po më duket se është kanë edhe një herë.

Sabri Murseli – Po Kryesues është adhur për këmbim dhe vlerësim prej Ministrisë, ka të bëjë me parcelën 963-1 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë private me pjesën e ngastrës kadastrale 7-0, Z.K. Muhoc, vlerësimet i kanë ba nga Ministria e financave, që është komisioni në kuadër të departamentit tatimit në pronë, prona private është pjesëtuar me 8800 ose me 88m² prona e komunës është vlerësuar me 40 m², është një komision profesional që simbas vlerave e konstatonë, mirëpo unë jam i pajtimit me vlerësimin e ministrisë dhe se nuk kanë konflikt interesi.

Brahim Osmani – Unë për herë parë në seancë po e them se e njohë këtë person dhe di shka mundet me ba ky person, është i komunës tonë dhe se është kërkesa e tij, e di se ai tokën e paguan dyfish, apo 10 fish, po më vjenë mirë që ministria e kanë vlerësuar shumë më pak se sa është dashtë me ja dhanë, unë jam kundër pavarësisht që i bjen, mendoj se ai ka me këqyre se sa shkonë më së miri ari, e tani ju bjenë juve këtu, po shihet edhe puna e tenderave, ja japim edhe udhëzimin edhe paguan me pare dhe ja japin tenderin, faliminderit.

Flamur Istrefi – Kryesues është mirë që këto prona me na ardhë propozimi, është komisioni komunal që është i përcaktum për këmbimin e pronave edhe ata me i ba propozimet, veç logjikoje pronën 80 euro me 8 euro me 40 euro, 5 fishin me e dhanë, dhe kjo ka diferencë prona prej pronës, nuk është në të njejtën zonë edhe rasti konkret po flas në përgjithësi, kohët e fundit, asnjë propozim nuk e keni prej komisionit, e keni prej personave, nuk është në rregullë, mujna me i kalu krejtë, po është mirë në bazë të komisionit, në bazë të komisionit me i pas dy tri propozime edhe jemi në rregullë.

Sabri Murseli – Kryesues nëse më lejon, këmbimin e ka pasë edhe në pjesën e parë, ka qenë interes e komunës, e tash e kemi qu në komision edhe me e pru këtu në takim edhe me ju ofru komuna për këtë projekt, nëse pala ka përdorë tri opsione që i jep komisioni i komunës me tender nëpërmes të kryetarit me vendim, atëherë i lyp dy apo tri apo katër opsione, e bina projektorin në kuvend dhe i këqyrim të gjitha, në kesi raste me kërkesë të palës nuk ki qysh me vepru, por nëse prap ka kërkesë pala, ajo kërkesë nuk kalon, por nëse bahet mirë bahet, e nëse nuk bahet refuzohet, për këtë arsye e ki në bazë të kërkesës së palës, shumë mirë e dini ju se si i kam ba raportet në bazë të kërkesës së palës, me gjetë një komision me kry punën, se është më lehtë edhe për mua.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Po kjo është në interes të palës, a ka dikush tjetër, përfituesit më të mëdhenj janë ata që i bajnë vlerësimet, qysh është në qytet dhe fshat është barabar, kush është që të kaloj në kuvend pika e XVI-të, faliminderit?, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e XVII-të.

Pika 17

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për këmbimin e pjesës të ngastrës kadastrale; 532-5 Z.K. Talinoc i Jerlive, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 690-5, Z.K. Talinoc i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt;

Sabri Murseli – Kryesues ky propozim me 23 m² me 13m², 13m² është e prona e komunës Ferizaj 690-5 Z.K. Talinoc i Jerlive dhe këmbehet me 23 m² e që është pronë private Z.K. 532-5 Talinoc i Jerlive, prona e komunës është vlerësuar 290.00€ e kurse ajo private 160.00€, e në bazë të vlerësimit këmbimi i paluejtshmërive do të bëhet ashtu si është përcaktu në nenin I të këtij vendimi.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Po kjo është në interes të palës, a ka dikush tjetër, kush është që të kaloj në kuvend pika e XVII-të, faliminderit?, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e XVIII-të.

Pika 18

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale; 667-1 dhe 667-2 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 286-0 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë e Komunës së Ferizajt, urdhëro Drejtor.

Pika 19

Sabri Murseli - Faliminderit kryesues edhe ky propozim ka të bëjë për këmbim dhe është në interes të palës, 667-1 Z.K.Talinoc i Muhaxherëve me sipërfaqe prej 231m² dhe 667-2 Z.K.Talinoc i Muhaxherëve me sipërfaqe prej 225m² dhe pjesa e ngastrës kadastrale 286-0 Z.K.Talinoc i Muhaxherëve, pronë e Komunës së Ferizajt me sipërfaqe 608 m², **në përshkrim janë vlerat:**

286-6 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve është vlerësuar prona e komunës për m² - 60.00 euro
667-1 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve është vlerësuar 80.00 euro m² prona private, kurse
667-2 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve është vlerësuar 80.00 euro m² prona private

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush tjetër, kush është që të kaloj në kuvend pika e XIX-të, faliminderit?, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e XX-të.

Pika 20

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Vazhdojmë me Propozim – ndryshim i Vendimit 01.Nr. 56 i datës 20.06.2024 për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033; kush është që të kaloj në kuvend pika e **XX-të**, faliminderit?, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën të ndryshme.

Pika 21

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush tjetër në të ndryshme?, urdhëro Flamur!

Flamur Istrefi – Theksoi se kishte me qenë mirë që ta kemi një informatë nga Drejtoria e Arsimit për fillimin e Vitit të ri shkollor.

Procesmbajtësja


Zyliha Tafarshiku



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi